



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 919/16 prot.

Tiranë më 15.9.2017

URDHËR

Nr. 234, datë 15.9.2017

PËR

SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, TË CILAT KANË  
TEJKALUAR AFATIN LIGJOR TË PËRPUNIMIT

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 29 dhe 30 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.160, datë 14.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Fondacioni "Shpresë për Botën" Vorë - Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Fondacioni "Shpresë për Botën" Vorë – Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.160, datë 14.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Fondacioni "Shpresë për Botën" Vorë - Tiranë, është subjekt juridik, NIPT: J6221400IL, me aktivitet shërbimin social të përkujdesit për fëmijët jetimë dhe atyre me probleme sociale, për moshat 14-18 vjeç. Ky kontrollues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave "punëmarrës" e "fëmijë".

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:**

1. Kontrolluesi Fondacioni "Shpresë për Botën" Vorë - Tiranë, nuk ka kryer detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.

Konstatimi i pikës 1 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

*"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se*

*kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.*

2. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, nuk disponon rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale, por disponon rregulloren funksionale të veprimtarisë së tij, ku parashikohen disa parime mbi konfidencialitetin.

Konstatimi i pikës 2 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar: *“1.Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.*

*2.Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:*

*2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.*

3. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, nuk ka tabela informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave survejuese CCTV, si dhe rregullore për funksionimin e këtij sistemi.

Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar: *“1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.*

*2. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënies së të dhënave personale”.*

4. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, në arkivën e tij disponon dosjet e fëmijëve, të cilat datojnë që në fillimet e veprimtarisë së tij, viti 1995. Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 5, germa “d” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:

*“1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:*

*d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.*

5. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, nuk aplikon “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, por ka disa formularë mbi konfidencialitetin, për punëmarrës dhe vizitorë, formate këto që nuk përputhen me standardin e Deklaratës së Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit, ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, masat për shpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimin e punëdhënësit.** Konstatimi i pikës 5 të këtij procesverbali përbën shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:

“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

6. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, në marrëdhënien juridike me palën e tretë, mirëmbajtësin e sistemit të kamerave CCTV, nuk ka një marrëveshje konfidencialiteti sipas Udhëzimit Nr.19 datë 03.08.2012 të Komisionerit.

Konstatimi i pikës 6 të këtij procesverbali, përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:

*“1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:*

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;*
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;*
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;*
- d) t’i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t’i mbajë apo t’i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit,*
- e) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.*

*2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin.”.*

Gjatë hetimit administrativ konsatohet mbajtja e dosjeve me të dhëna personale sensitive të përfitueseve, më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Këto dosje, përmbajnë të dhëna sensitive me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private të fëmijëve.

Neni 3 “Përkufizime”, pika 4 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përcakton se:

*“Të dhëna sensitive” është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale”.*

Zyra e Komisionerit pas përfundimit të procedurës së kontrollit ka dalë me aktin rekomandues, Nr.32 datë 24.07.2017, në lidhje me shkeljet e konstatuara sipas pikave të procesverbalit të mësipërm, ku ndër të tjera rekomandon:

*“Në zbatim të nenit 5, germa “d” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, të parashikojë në rregulloren për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”, afatet ligjore të ruajtjes së të dhënave personale (dosjet) e përfituesve “fëmijë”.*

Ruajtja e dosjeve të fëmijëve, pa një afat të caktuar edhe pasi ka mbaruar qëllimi për të cilin ato janë mbledhur, përbën shkelje të kësaj të drejte themelore të tyre.

Ë drejta e tyre për privatësi sanksionohet gjithashtu, në nenin 17 të Ligjit Nr.18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, pika 2 citon:

*“2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse”.*

Në konsultimet paraprake që Zyra e Komisionerit ka zhvilluar me palët e interesuara, është konkluduar se, afati i mbajtjes së dosjeve të kategorisë “fëmijë” nuk duhet të jetë më shumë se 10 vjet nga dalja e fëmijës prej qendrës, duke marrë parasysh dhe monitorimin afatgjatë të tyre pas daljes nga qendra e trajtimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, konkretisht të fëmijëve, përpunimi i paligjshëm i të cilave sjell pasoja të pariparueshme të jetës dhe privatësisë së tyre.

Neni 30, paragrafi 1, germa “b” e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përcakton se:

*“1. Komisioneri ka këto të drejta:*

*b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale”.*

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 7, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

## **URDHËROJ:**

1. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale sensitive (dosjet) e subjekteve të të dhënave, kategoria “fëmijë”, që kanë mbi 10 vjet nga përfundimi i qëllimit për të cilin janë mbledhur.

2. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, të parashikojë në rregulloren për “Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”, afatin 10 vjeçar të mbajtjes së dosjeve të fëmijëve pas daljes së tyre nga qendra e trajtimit.
3. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, të realizojë seleksionimin e dosjeve që disponon, deri në klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre si:
  - a. Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në përputhje me afatet ligjore.
  - b. **Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në shkelje të afateve ligjore.**
4. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, pasi të ketë vepruar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale sensitive (dosje), të arkivuara në kundërshtim me afatet ligjore.
5. Kontrolluesi Fondacioni “Shpresë për Botën” Vorë - Tiranë, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 60 ditëve.
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më, 15/9 /2017

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Besnik Dervishi". The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "KOMISIONERI" at the top, "Besnik Dervishi" in the center, and "TIRANË" at the bottom. The stamp also features a central emblem and some smaller, less legible text around the perimeter.